




REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS  
SUDESKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL



KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS (KGJK), në bazë të nenit 108 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 12, paragrafit 2 dhe 3 dhe nenit 18 paragrafi 1 nënparagrafi 1.2 të Ligjit nr. 06/L-055 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, në mbledhjen e 210-të, të mbajtur me datë 10 janar 2019, merr këtë:

### V E N D I M

- I. Gjyqtari i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme z. Çerim Fazliji, PEZULLOHET nga detyra e gjyqtarit, gjatë shërbimit në Këshill si kryetari i Komisioni për Administrimin e Gjykatave, i cili pezullim do të përfundojë me datë 14 shkurt 2020;
- II. Z. Fazliji gjatë kësaj kohe do të gëzojë pagën ekuivalente të gjyqtarit të Gjykatës Supreme;
- III. Z. Fazliji nuk do të humbas statusin e tij si gjyqtar dhe ka të drejtë t'i kthehet shërbimit si gjyqtarë në gjykatën në të cilën ka shërbyer para emërimit në pozitën sipas pikës I të dispozitivit të këtij vendimi;
- IV. Vendimi hyn në fuqi nga data 11 janar 2019.

### A r s y e t i m

Ligji Nr. 06/L- 055 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës është shpallur me dekretin Nr. DL-058-2018, datë 13.12.2018 nga Presidenti i Republikës së Kosovës. Në bazë të nenit 44 ky ligj hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës. Publikimi i ligjit në fjalë në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës është bërë me datë 26 dhjetor 2018.

Z. Fazliji është zgjedhur anëtar i KGJK-së me datë 27 shkurt 2017, ndërsa kryetari i Komisionit për Administrimin e Gjykatave me mandat prej datës 15.02.2018-14.02.2020.

Neni 12 paragrafi 2 Ligji Nr. 06/L-055 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës obligon kryetarin e Komisionit për Administrimin e Gjykatave që të shërbejë në Këshill me orar të plotë dhe të pezullojë detyrën e gjyqtarit.

Duke marrë parasysh gjithçka që u tha më lartë KGJK vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

  
Nehat IDRIZI,  
Kryesues i Këshillit Gjyqësor të Kosovës

*Kopja e vendimit i dërgohet:*

- *Z. Çerim Fazliji, Gjyqtar, Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme;*
- *Z. Sahit Sylejmani, Kryetar, Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme;*
- *Drejtorit të Sekretariatit të KGJK-së;*
- *Arkivës.*